



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIK A KOSOVA - REP. PUB. OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMY OF JUSTICE			
Niveli, Org. Org. Juri. Org. Lart	01	Nr. Prot. Pr. Prot. Prot. No.	398
Nr. Fregate Br. Stranica No. Pages	01	Data Datum Date	22.11.2021
Prishtinë / u			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademia Pravde/Academy of Justice

Nr: 01/398/2021

Datë: 29.10.2021

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë

Në mbështetje të nenit 11, pika 4 të Ligjit Nr. 05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë, dhe nenit 18 të Rregullores Nr.02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, njëzëri në mbledhjen e mbajtur me datë 23.06.2021, merr këtë:

VENDIM

- I. Miratohet, pa vërejtje Procesverbali i Mbledhjes së Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, i mbajtur me datë 23 qershor 2021.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia. Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. En. Prot. Prot. No.	399
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	01	Data Datum Date	22.11.2021
Prishtinë / u			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/399/2021
Datë: 29/10/2021

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë në mbështetje të nenit 12, pika 1.5 të Ligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë dhe nenit 6, pika 1.8 të Rregullores Nr.02/2017 për punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë si dhe pas paraqitjes së dorëheqjes me shkrim, në mbledhjen e mbajtur më 29.10.2021, merr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet dorëheqja e znj. Saranda Çunaku**, nga pozita e anëtares së Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë nga radha e Ministrisë së Drejtësisë.
- II. Znj. Saranda Çunaku**, me datën 08 tetor 2021, përmes postes elektronike (email-it) ka njoftuar drejtorinë e Akademisë së Drejtësisë z. Enver Fejzullahu për ofrimin e dorëheqjes nga pozita e anëtares së Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, si përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë, pasi që ka kaluar në pozitën e re të punës si Këshilltare e lartë kushtetuese juridike në Gjykatën Kushtetuese. Kjo dorëheqje nga ajo është kërkuar me efekt të menjëhershëm.
- III. Mandati i anëtares së përmendur në pikën I**, i pushon nga dita e nxjerrjes së këtij vendimi sipas legjislacionit në fuqi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë.**

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit të Akademisë së Drejtësisë
- znj. Saranda Çunaku, anëtare e Këshillit Drejtues të AD-së,
- Ministrisë së Drejtësisë



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia Org. Org. Jedite. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	391
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	2	Data Datum Date	11.11.2021
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/391/2021
Datë: 29/10/2021

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë në mbështetje të nenit 10, pika 1.8, nenit 14 dhe 15 të Ligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, nenit 6, pika 1.8 të Rregullores Nr.02/2017 për punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë dhe të kriterëve profesionale në mbledhjen e mbajtur më 29.10.2021, merr këtë:

V E N D I M

I. Pas shqyrtimit të kandidateve në listën e te nominuarve nga gjykatat dhe prokuroritë përkatëse, përmes procedurës së votimit të hapët dhe njëzëri anëtarë-e të Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë, u zgjedhën kandidatët në vijim:

1. Mejreme Memaj, gjyqtare e Gjykatës Supreme të Kosovës.
2. Nora Bllaca Dula, gjyqtare në Gjykatën e Apelit të Kosovës.
3. Lumnije Krasniqi, gjyqtare në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni për Çështje Penale në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
4. Atdhe Berisha, gjyqtar në departamentin e përgjithshëm të Gjykatës Themelore të Prizrenit.
5. Agim Kurmehaj, Kryeprokurore i Prokurorisë Themelore në Pejë.
6. Arbëresha Raça-Shala, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.


II. Mandati i anëtarëve të përmendur në pikën I. të Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë është katër (4) vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandatë.

III. Anëtarët e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë, funksionin e tyre do ta ushtrojnë në bazë të legjislacionit në fuqi.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë.

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë



Vendimi i dërgohet:

- Arkivit të Akademisë së Drejtësisë
- Anëtarëve të Këshillit Programor të AD-së



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIA PRÄVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia. Org. Org. Acctg. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	392
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	/	Data Datum Date	11.11.2021
Përkrahës / L			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr: 01/392/2021

Datë: 29.10.2021

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 6 pika 1.1 dhe 1.2, nenit 10 pika 1.1-1.5, pika 2, nenit 19, (pika 1,2,3,6) të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë dhe, Rregullores Nr. 03/2017 - për Trajnimin Fillestar e dt. 07.06.2017, Neni 18, (pika 1,2,3,4.) nenit 20 (pika 1, 2,), Rregullores 01/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 03/2017 - Për Trajnimin Fillestar, nenet 3,4, Rregullore 07/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores 03/2017 - Për Trajnimin Fillestar, neni 6, pika 3., dhe Rregullores Nr. 02/2017 - për punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë e dt. 07.06.2017, neni 6 pika (1.5, 1.9) dhe nenit 17, **në çështjen e ankesës së znj.Rrezarta Lleshaj**, në mbledhjen e mbajtur më 29 tetor 2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet si e pabazuar ankesa** e Rrezarta Lleshajt nr.353 e datës 23.09.2021 gjyqtare e sapoemëruar - vijuese e Programit për Trajnim Fillestar (PTF-së) e gjeneratës së VIII në Akademinë e Drejtësisë, dhe **miratohet rekomandimi** i datës 07 tetor 2021 i Komisionit të Ankesave për Vlerësim në PTF i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur me 07 tetor 2021 për këtë çështje.

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses-gjyqtares znj Rrezarata Lleshaj
- Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
№. Dreg. Cep. Dreg. Cep. LSH	01	№ Prot. Pr. Prot. Prot. No.	400
№. Fqese No. Strana No. Pages	01	Data Datum Date	22.11.2021
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/400/2021
Datë: 29/10/2021

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë në mbështetje të nenit 10, pika 1.9 dhe 2, të Ligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, nenit 6, pika 1.9 të Rregullores Nr.02/2017 për punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë në mbledhjen e mbajtur më 29.10.2021, merr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi për shfuqizimin e Vendimit -nr. 01/287/2017 i dt.01/12/2017 për Komisionin e ankesave për rezultatin e testeve i Akademisë së Drejtësisë.**
- II. Obligohet Akademia e Drejtësisë që në të ardhmen e afërt përmes procedurës ligjore të ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores së PTF-së të rregullojë çështjen në fjalë.**
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë.**

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit të Akademisë së Drejtësisë
- Anëtarëve të Këshillit Programor të AD-së



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMY OF JUSTICE			
Njësia. Org. Org. Justice Org. Unit	01	Nr. Prot. Re. Prot. Prot. No.	401
Nr. Faqesh Re. Stranica No. Pages	02	Data Datum Date	22.11.2021
Printuesh / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/401/2021
Datë: 29/10/2021

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë në mbështetje të nenit 10, pika 1.9, të Ligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, nenit 6, pika 1.9 të Rregullores Nr.02/2017 për punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë në mbledhjen e mbajtur më 29.10.2021, lidhur me Memorandumin e Mirëkuptimit dhe Protokollit për trajnimet e detyrueshme dhe trajnimet shtesë të prokurorëve të shtetit, merr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet njëzëri Propozimi** për nënshkrimin në parim të Memorandumit të Mirëkuptimit për trajnimet e detyrueshme dhe trajnimet shtesë të prokurorëve ndërmjet Akademisë së Drejtësisë dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- II. Për çështjen e** 'PROTOKOLIT TË PËRBASHKËT I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS DHE AKADEMISË SË DREJTËSISË PËR TRAJNIMET E DETYRUESHME DHE TRAJNIMET SHITESË PËR PROKURORËT ME PERFORMANCË TË DOBËT', u vendos që pas finalizimit të draftit në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK-së), të bëhet në procedurë të rregullt nënshkrimi dhe zbatimi i tij nga ana e AD-së dhe KPK-së.
- III. Njëkohësisht KD i AD-së** autorizon koston shtesë të shpenzimeve financiare për zhvillimin e këtyre moduleve trajnuese (trajnimeve të detyrueshme) sipas vendimeve të KPK-së (e cila do të precizohet pas llogaritjes financiare).

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë.

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë



Vendimi i dërgohet:

- Arkivit të Akademisë së Drejtësisë
- Anëtarëve të Këshillit Programor të AD-së



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia. Org. Org. Unit	01	Nr. Prot. Prot. No.	402
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	02	Data Datum Date	22.11.2021
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr: 01/402/2021

Datë: 29.10.2021

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.4) dhe nenit 25 (paragrafi 3) të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, nenit 6 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.4) të Rregullores Nr.02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, nenit 14 të Rregullores Nr.02/2019 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.10.2021, merr këtë:

VENDIM

- I. Miratohet propozimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për mentore në lëmin penale, të znj. Anita Krasniqi-Prenaj, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë për gjyqtaren me mandat fillestar znj. Rrezarta Lleshaj në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
- II. Mandati i mentores të emëruar zhvillohet në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe përfundon me përfundimin e Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar, dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë dhe Rregulloren Nr.02/2019 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë.
- III. Mentori angazhohet për të zbatuar programin e trajnimit praktik për periudhën tre (3) mujore, duke filluar nga muaji Dhjetor 2021.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë.

Arsyetim

Akademia e Drejtësisë, me datë 13.10.2021, ka pranuar kërkesën me propozim nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për miratim të mentorit në lëmin penale të znj. Anita Krasniqi-Prenaj, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë për gjyqtaren me mandat fillestar znj. Rrezarta Lleshaj në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Me datë 07 tetor 2021, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka marrë vendim për propozimin e znj. Anita Krasniqi-Prenaj, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për mentore në lëmin penale.

Këshilli Drejtues, në takimin e mbajtur me 29 tetor 2021, pas shqyrtimit të kërkesës së KGJK-së, lidhur me të njëjtën vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

z. Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues

Akademia e Drejtësisë



Vendimi i dërgohet:

- Udhëheqësit të Programit Fillestar të AD-së
- z. Anita Krasniqi-Prenaj, gjyqtar në Gjykatën Themelore Prishtinë,
- znj. Albina Shabani-Rama, kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë,
- Arkivit të Akademisë së Drejtësisë